

Federata e Futbollit e Kosovës (tutje referuar si “FFK”) konform nenit 68, të Ligjit nr. 2003/24 për Sportin (tutje referuar si “Ligji për Sportin”), si dhe konform nenit 34, paragrafi 3, nën-paragrafi (b), pika 6 si dhe konform nenit ..... të Statutit të Federatës së Futbollit të Kosovës të vitit 2023, nepërmjet Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, me datë 26.10.2023 shpall publikisht këtë:

## **FTESË PËR OFERTË**

### **Për të drejtat ekskluzive të shitjes e veshjeve sportive të Kombëtares – FFK (FFK)**

**Hyrje:** FFK është organi më i lartë udhëheqës i futbollit në Kosovë dhe e njëjta konform nenit 68, të Ligjit për Sportin, është pronare e të gjitha të drejtave komerciale për ligat dhe ekipet kombëtare të futbollit në Kosovë. FFK duke qenë pronare e të drejtës komerciale e garave që organizohen në Kosovë është e interesuar që të drejtën për shitjen e veshjeve dhe materialeve tjera të Kombëtares dhe FFK-së, subjektit që bënë oferten më të pranueshme për FFK-në. FFK synon që përmes shitjes së këtyre të drejtave, qytetarin e Kosovës ta vendosë sa më afër futbollit vendor.

#### **1. Kontraktuesi:**

Palë kontraktuese e ofertuesit të suksesshëm do të jetë Federata e Futbollit të Kosovës, me adresë në rrugën “28 Nëntori” numër 171, 10 000 Prishtinë.

#### **2. Lënda e Kontratës:**

Lëndë e kontratës do të jetë e drejta ekzkluzive për shitjen e veshjeve sportive të Kombëtares dhe FFK-së.

#### **Kohëzgjatja e Kontratës:**

Kohëzgjatja e kontratës të lidhur me ofertuesin e suksesshëm do të jetë nga data 1 vit me mundësi vazhdimi.

#### **3. Vendi i përmbushjes:**

Vendi i përmbushjes do të jenë 7 regjione e Kosovës minimalisht.

#### **4. Mënyra e përzgjedhjes së ofertuesit:**

FFK do të ftojë dhe të këshillohet me ofertuesit e zgjedhur të cilët i kanë përmbushur kërkesat për përshtatshmëri, kërkesat mbi gjenjen ekonomike dhe financiare, kërkesat për përshtatshmëri profesionale, dhe kërkesat mbi mundësitë teknike si janë të përcaktuara me këtë ftesë dhe zgjedhjen e tyre do ta bëjë me anë të negociatave dhe këshillimeve. Pas këshillimit dhe negociatave, FFK do të përzgjedh ofertuesin me të cilin do të nënshkruaj Kontratën.

#### **5. Subjektet e përshtatshëm për ofertim:**

- 5.1. Ofertë në bazë të kësaj ftesë mund të paraqesin vetëm subjektet të cilët i plotësojnë të gjitha kushtet e caktuara në këtë ftesë për ofertë.
- 5.2. Të gjitha ofertat e parashtruara nga subjektet të cilat nuk i plotësojnë kushtet e cekura në këtë ftesë nuk do të shqyrtohen nga FFK.

#### **6. Afati dhe forma e dorëzimit të ofertës:**

- 6.1. Afati për paraqitjen e ofertës është 10 (dhjetë) ditë, dhe i njëjti fillon të rrjedhë nga publikimi i kësaj ftesë në web faqen [www.ffk-kosova](http://www.ffk-kosova) përkatësisht nga data 26.10.2023 deri më datë 06.11.2023.
- 6.2. Të gjitha ofertat e dorëzuara pas datës 06.11.2023 nuk do të shqyrtohen nga FFK.
- 6.3. Oferta mund të dorëzohet në njërin nga format si në vijim:
  - ❖ fizikisht në FFK në rrugën “ 28 Nëntori”, numër 171, 10 000 Prishtinë, të cilat protokolohehen nga stafi i FFK-së;
  - ❖ përmes fax-it zyrtar: 038 548 560;
  - ❖ përmes e-mailit: [ffk-kosova@hotmail.com](mailto:ffk-kosova@hotmail.com) të skanuara.
- 6.4. Të gjitha ofertat e dorëzuara duhet të jenë të nënshkruara nga personat kompetent dhe të vulosura nga me vulë të biznesit.
- 6.5. Ofertat e dorëzuara në ndonjë formë tjetër nga ato të cekura si më lartë nuk do të shqyrtohen nga FFK.

6.6. Ofertat të cilat nuk janë të nënshkruara dhe të vulosuara nuk do të shëyrtohen nga FFK.

**7. Kërkesat për përshtatshmëri të ofertës:**

**7.1. Oferta e ofertuesit, nuk do të konsiderohet e përshtatshme, nëse ofertuesi, ndonjë punëtor, menaxher ose drejtor i tij, apo ndonjë subjekt i ndërlidhur më të:**

- a. Ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e ftesës për të bërë ofertë, apo ndonjë dokumenti tjetër i cili është pjesë e ftesës për të bërë ofertë;
- b. Në të gjitha rastet kur paraqitet konflikt interesi;

**8. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe finaciare:**

- a. Ofertues duhet që 3 (tre) vitet e fundit të ketë qarkullim bankar mbi 800.000 (tetëqind mijë) euro dhe këtë ta provojë përmes gjendjes së llogarisë bankare.
- b. Ofertuesi duhet të ofrojë ofertë financiare për përfitimet e FFK-së, në rast se i njëjti shpallet i sukseshëm

**9. Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:**

- a. Ofertuesi duhet që të jetë biznes i regjistruar pranë Agjencisë për Regjistrimin të Bizneseve në Kosovë. *(Ofertuesi duhet të dorëzojë certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe konfirmimin se biznesi është aktiv në kohën kur dorëzohet oferta);*

**10. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:**

- a. Ofertuesi duhet të garanton të ketë minimum 1(një) pikë në Prishtinë
- b. Ofertuesi duhet të dëshmoj rrjetin e shperndarjes në 6 regjionet e Kosovës përpos Prishtinës (Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Prizren, Ferizaj)
- c. Bashkepuntori duhet garantoj që brendimi i shtandeve jashte Prishtinës do të behet sipas udhezimit të FFK-së
- d. Ofertuesi duhet të garantoj që malli i porositur do të jetë në bashkëpunim me FFK-në
- e. Ofertuesi duhet të deponoj dëshmi mbi bashkëpunimin me klube futbollistike dhe federate te tjera sportive.

**11. Të tjera:**

Ofertuesit nuk kanë të drejtë të kërkojnë kompensim nga FFK për përgatitjen e materialit ofertes apo për negociatat eventuale.